



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II.nr.1348/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi nga Prishtina kundër debitorit Telekom i Kosovës Dega në Obiliq, në procedurën e përmbarimit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.280/20 i datës 15.10.2021, jashtë seancës me datën 05.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave Pastrimi nga Prishtina, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.280/20 datës 15.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar PPP.nr.280/20 i datës 15.10.2021, e ka aprovuar të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës Dega në Obiliq, të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.674/2019 të datës 18.11.2019, me të cilin përmbaruesi privat Driton Govori nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me datë 18.11.2019, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit, në emër të pagesës së borxhit në shumë prej 473.4€, për kryerjen e shërbimeve komunale të bartjes së mbeturinave, të cilat sipas nenit 21 dhe 29 të LPK-së, paraqet dokument të besueshëm dhe është i përshtatshëm për përmbarim.

Kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh faktet relevante, sepse urdhëri për përmbarim nuk përkon fare me periudhën kontestuese që e trajton vendimi i Qeveris dhe ndarjen e obligimeve mes dy subjekteve në fjalë. Pretendimi i debitorit se borxhi përkon me një periudhë të mëparshme nuk qëndron për arsye se obligimi i takon nga viti 2019 dhe për më tepër ky borxh bazohet në kontratën e nënshkruar mes palëve e nënshkruar dhe protokolluar nga Telekom i SH.A me nr.... Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë dispozitat në fuqi. Propozon që të aprovohet ankesa e kreditorit, ndërsa aktvendimi i atakuar të anulohet si i pabazuar, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përbarim ndaj *debitorit* në bazë të dokumentit të besueshëm në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit, në emër të pagesës së borxhit në shumë prej 473.4€, për kryerjen e shërbimeve komunale të bartjes së mbeturinave, dhe Përbaruesi privat Driton Govori nga Prishtina ka lejuar përbarimin me urdhrin P.nr.674/19 të datës 18.11.2019, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.03.2020.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, jashtë seance ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, PPP.nr.280/20 i datës 15.10.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës Dega në Obiliq, të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.nr.674/2019 të datës 18.11.2019, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar, me arsyetimin se debitori ka përmbushur të gjitha detyrimet të cilat rrjedhin nga periudha për të cilën është kërkuar përbarimi. Gjykata ka konstatuar se është përmbushur detyrimi të cilin debitori e ka pasur ndaj kreditorit për periudhën prej 28.02.2019 e deri me 31.10.2019 në shumë prej 473.40€

Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo zbatimit të gabuar të drejtës materiale. Sipas vlerësimit të Dhomës së Shkallës së Dytë, drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përbarimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Dhoma e Shkallës së Dytë e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përbarimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor i kreditorit se urdhëri për përbarim nuk përkon fare me periudhën kontestuese, për Dhomën e Shkallës së Dytë është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se “ Organi përbarues e cakton, përkatësisht e

zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Në këtë rast në shkresat e lëndës si provë materiale përveç tjerash gjendet kartela e konsumatorit e datës 05.10.2020, nga e cila vërtetohet se debitori ka përmbushur detyrimet ndaj kreditorit për periudhën prej 28.02.2019 deri 31.10.2019, përderisa kreditori nuk ka dhënë ndonjë argument tjetër për ti kundërshtuar pretendimet e shlyerjes së borxhit të faturuar për debitorin, e të cilën shumë kreditori e ka arkëtuar shumën prej 1,525.42€. Dhoma e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

Kom.Dh.Shk.II nr.1348/22 datë 05.09.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha